



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2019:127530

Datë: 07.02.2025

Numri i dokumentit: 06820817

P.nr.276/17

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - DEGA NË VUSHTRRI, Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni penal, gjyqtari i vetëm gjykues Agron Maxhuni, në çështjen penale kundër të pandehurit K.U., nga Vushtrria , për shkak të veprës penale Uzurpimi i paligjshëm i pronës së paluajtshme nga neni 333 par 2 nën pa 2.2 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, PP.nr.743/2017, të dt.16.10.2017, duke vendosur sipas nenit 511 par.1 të KPPK-së, më datën 07.02.2025 jashtë seancës, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. PUSHOHET procedura penale ndaj të pandehurit K.U., data e lindjes , me numër të letërnjoftimit ..., nga Vushtrria Rruga "...", sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë PP.nr.743/2017, të dt. 16.10.2017, për shkak të veprës penale Uzurpimi i paligjshëm i pronës së paluajtshme nga neni 333 par 2 nën pa 2.2 të KPRK-së, pasi që ndaj pandehurit gjykata ka marrë aktvendim CN.nr.34/2023 të datës 29.05.2023 *për Heqjen plotësisht dhe në mënyrë të përhershme të zotësisë për të vepruar.*

II. Shpenzimet e procedurës penale mbesin në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzën PP.nr.743/2017, të dt. 16.10.2017 kundër të pandehurit K.U., nga Vushtrria , për shkak të veprës penale Uzurpimi i paligjshëm i pronës së paluajtshme nga neni 333 par 2 nën pa 2.2 të KPRK-së.

Gjyqtari i vetëm gjykues, pas pranimit të lëndës nga gjyqtari paraprak me datë 03.06.2021 i cili është pensionuar, ka ndërmarrë veprime dhe ka caktuar seancat e shqyrtimit gjyqësor lidhur me trajtimin e kësaj çështje të cilat seanca nuk janë mbajtur për arsye të mungesës së palëve, respektivisht të të pandehurit dhe atë për shkaqe shëndetësore.

Gjykata në seancën e mbajtur me datë 07.02.2025 është njoftuar nga administrata se ndaj të pandehurit në procedurën jokontestimore pas mbajtjes së seancës dhe dëgjimit të ekspertëve të

Instituti të Psikiatrisë Forenzike të Kosovës, në Prishtinë respektivisht pas konstatimit dhe mendimit të ekspertëve Dr. A.B., Dr. B.O. dhe Dr. B.H., respektivisht ekzaminimit të drejtpërdrejtë gjykata me aktvendimin CN.nr.34/2023 të datës 29.05.2023 i plotfuqishëm me këtë datë, ka Hequr plotësisht dhe në mënyrë të përhershme zotësisë për të vepruar, pasi që ka vërtetuar se kundër propozuesi respektivisht i pandehuri K.U. ka një çrregullim mendor, i cili në bazë të Klasifikimit ndërkombëtar të sëmundjeve ICD-10, kodohet si F00, që ka të bëjë me demencë të tipit Alzaimer, çrregullimi i tillë mendor ka të bëjë me çrregullim të funksioneve të larta kortikale, ku përfshihen të folurit, të shkruarit, memoria, gjë që reflektohet në dëmtim të funksionit të përgjithshëm të të ekzaminuarit.

Andaj, gjykata duke vepruar sipas detyrës zyrtare e në pajtim me nenin 511 të KPPK-së ku është përcaktuar se “*Nëse gjykata vendos se i pandehuri është i paaftë për t’iu nënshtruar gjykimin gjatë procedurës për shkak të sëmundjes së përhershme mendore, ajo merr vendim për pushimin e procedurës*”, në rastin konkret gjykata duke u bazuar edhe në aktvendimin CN.nr.34/2023 të datës 29.05.2023 i plotfuqishëm me këtë datë, i cili aktvendim ka Hequr plotësisht dhe në mënyrë të përhershme zotësisë për të vepruar, ka vendosur të pushojë procedurën penale ndaj të pandehurit si në dispozitiv të aktvendimit.

Në përputhje me nenin 453 par.1 të KPPK është vendosur që shpenzimet e procedurës penale të ngelin në ngarkesë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

Në bazë të nenit 551 par. 1 dhe 453 par.1 të KPPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI

Departamenti i përgjithshëm-Divizioni Penal

2019:127530, datë 07.02.2025

Gjyqtar i vetëm gjykues
Agron Maxhuni

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, mund të ushtrohet ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës brenda afatit prej 5 (pesë) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit. Ankesa ushtrohet nëpërmes kësaj Gjykate në kopje të mjaftueshme.